



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:042650
Datë: 23.07.2024
Numri i dokumentit: 05971860

C.nr.661/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Genc Hasani, në kontestin e paditësit Burim Asllani nga Mitrovica, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Jeton Hasani nga Prishtina, kundër të paditurës Trepça Sh.A, me seli ne Parkun Industrial ne Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Arianit Voca, me objekt kontesti: Anulim vendimi, pas mbajtje se shqyrtimit kryesor, me datën 23.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Burim Asllani nga Mitrovica, ne tërësi si e bazuar, **ANULOHET** vendimi i datës 11.01.2024 me nr. të protokollit 243 i Bordit të Përkohshëm Mbikëqyrës të Trepça Sh.A.

II. DETYROHET e paditura Trepça Sh.A - t'ia paguaj paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 358.8 euro (me fjalë: treqind e pesëdhjetë e tete euro e tetëdhjetë cent), të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi me datën 06.02.2024, pranë kësaj gjykata ka paraqitur padi, kundër të paditurës Trepça Sh.A me të cilën ka kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm vendimi i datës 11.01.2024 me nr. të protokollit 243 i Bordit të Përkohshëm Mbikëqyrës të Trepça Sh.A., përmes të cilit është zgjedhur Kryeshf Ekzekutiv Z. Bashkim Kurti.

I autorizuari i paditësit në fjalën përfundimtare deklaroi se qëndrojnë ne tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë duke vlerësuar se ky vendim i kontestuar duhet te anulohet me faktin se konkursi i zhvilluar pranë te paditurës ka qene i shoqëruar me parregullsi te natyrave te ndryshme, jo vetëm qe kishte parregullsi ne përbërjen e bordit përzgjedhës dhe kushtet dhe kriteret qe ishin caktuar për përzgjedhjen e kryeshfiteve. Autorizuesi ka punësuar me gjerësisht ne padi por me

